



EDUKIMI

Sfida e re e Bankës së Shqipërisë



EDUKIMI KUSHTON POR NUK KA ÇMIM.

Që prej vitit 2006 ne kemi përfaquar një mendësi të re mbi edukimin ekonomik-financiar të publikut, duke e konsideruar këtë si sfidën e Bankës së Shqipërisë. Për realizimin e objektivave të punës tonë, midis të tjerave, ne ndihmohemi edhe nga mirëkuptimi që gjejmë në mjedisin ku veprojmë.

Edukimi në përgjithësi është një çështje e rëndësishme për vendin tonë. Ne besojmë që edukimi i publikut është detyrim i të gjitha institucioneve serioze e të përkushtuara në punën e tyre, sikundër është edhe Banka e Shqipërisë. Vitet e fundit, ne jemi përfshirë me shumë pasion, profesionalizëm e përkushtim në sqarimin e çështjeve të lidhura me aktivitetin e Bankës Qendrore, funksionin dhe objektivat e saj, rolin që ajo luan në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë së vendit.

Aktivitetet edukuese të Bankës së Shqipërisë aktualisht u drejtohen mësuesve dhe nxënësve të shkollave të mesme e nëntëvjeçare, studentëve e pedagogëve të fakulteteve brenda dhe jashtë vendit, gazetarëve të medias së shkruar e elektronike, punonjësve socialë, si dhe të gjithëve që me punën e tyre, transmetojnë njohuri dhe përmirësojnë jetën e të tjerëve.

Për ndërtimin e urave të komunikimit me publikun dhe krijimin e një kulture të mirëfilltë ekonomik-financiare të tij Banka e Shqipërisë bashkëpunon me institucione të tjera, me Ministrinë e Arsimit dhe

të Shkencës, median, shoqërinë civile dhe organizatat joqeveritare, shkollat e mesme dhe universitetet, bankat e nivelit të dytë etj..

Ne në Bankë e dimë që kjo është një rrugë e gjatë dhe jo kaq e thjeshtë, pasi rezultatet e punës në fushën e edukimit nuk janë lehtësisht të matshme. Por, në afat të gjatë, jemi të bindur se do të jenë plotësisht të frytshme.

AKTIVITETET EDUKATIVE 2007-2008



“BANKA QENDRORE NË JETËN E PËRDITSHME”

Ky është një program edukimi për publikun, i ideuar dhe i zhvilluar nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2007. Ai synon të shpjegojë rolin dhe funksionet e bankës qendrore, objektivat e saj kryesorë dhe mënyrën e realizimit të tyre, ndihmën dhe punën e Bankës për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe për rritjen e mirëqenies së përgjithshme, si dhe të kontribuojë në edukimin ekonomiko-financiar të të gjitha grupimeve të shoqërisë.

Siç tregon edhe vetë emërtimi, ky program synon të jetë sa më i dobishëm, duke prekur e ndihmuar jetën e përditshme të të gjithë shqiptarëve. Për këtë arsye, ai është përshtatur sipas nevojave të grupeve të ndryshme të interesit.

1. SEMINARE TRAJNIMI PËR MËSUESIT E LËNDËS SË EKONOMISË SË ZBATUAR.

Banka e Shqipërisë ka krijuar një marrëdhënie të veçantë me mësuesit e shkollave të mesme. Dhe kjo jo vetëm për përkushtimin, seriozitetin dhe frymën e bashkëpunimit që ata tregojnë gjatë “takimeve” me Bankën, por edhe pse programi edukues “Banka Qendrore në Jetën e Përditshme” i ka fillimet pikërisht në këto “takime”. Seminaret që zhvillohen përgjatë



gjithë vitit shkollor, synojnë të thelojnë dhe të pasurojnë njohuritë e mësuesve mbi bankingun qendror, Bankën e Shqipërisë dhe rolin e saj në ekonominë e vendit. Nëpërmjet organizimit të këtyre takimeve, Banka e Shqipërisë ka arritur të vendosë marrëdhënie ndërvepruese edukimi

me ata, që më mirë se kushdo tjetër mund të përçojnë aktivitetin dhe mendësinë e Bankës sidomos tek të rinjtë, tek nxënësit e tyre, por edhe tek të afërmit, miqtë dhe kolegët.

Gjatë vitit shkollor 2007- 2008, mbi 100 mësues të lëndës së ekonomisë të shkollave të mesme të Tiranës dhe Vlorës, kanë ndjekur me interes ciklin e seminareve të organizuara nga Banka e Shqipërisë për kualifikimin e mëtejshëm të tyre dhe janë pajisur me certifikata pjesëmarrjeje, për këto aktivitete.

2. TAKIME NË SHKOLLAT E MESME.

Drejtuesit e specialistët e Bankës së Shqipërisë zhvillojnë takime dhe biseda mbi funksionin e Bankës së Shqipërisë, mbi sistemin bankar dhe administrimin e financave personale me nxënësit e shkollave të mesme.



Gjatë kësaj periudhe, janë vizituar rreth 30 shkolla të mesme të vendit dhe kanë marrë pjesë në takime rreth 800 gjimnazistë të viteve të treta.



3. KONKURSI “VLERA E VËRTETË E PARASË”.

Të mësuarit nëpërmjet argëtimit është mënyra më e frytshme për të tërhequr vëmendjen e të rinjve drejt çështjeve pak të trajtuara në tekstet e tyre mësimore, si politika monetare. Duke ndjekur këtë parim u ideua dhe organizua konkursi “Vlera e Vërtetë e Parasë”.



E lidhur siç është me funksionin kryesor të Bankës Qendrore, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe hartimin e zbatimin e politikës monetare të saj, përmbajtja e këtij konkursi synon të krijojë e më pas të thellojë njohuritë e nxënësve në këtë fushë.



Ai u ofron atyre mundësinë e të mësuarit në grup, pjesëmarrjen në një sfidë gjatë së cilës përftohen njohuri të reja dhe mundësi për t'i dëshmuar aftësitë e tyre jo vetëm përpara bashkëmoshatarëve dhe mësuesve, por edhe një publiku më të gjerë.

Për këtë aktivitet edukues, specialistët e angazhuar hartuan një dokument përgatitor (rreth 70 faqe); një fjalor termash bankarë, i cili shumë shpejt do të botohet në formatin e një fjalorthi të vogël; si edhe një rregullore e cila shpjegon mënyrën e përfshirjes në konkurs dhe logjikën e organizimit të tij.

“VLERA E VËRTETË E PARASË”, TIRANË, PRILL 2008

Në konkurs morën pjesë 20 ekipe nga shkollat publike dhe jopublike të Tiranës. Sfida, e cila në fazën eliminatorë u zhvillua në hollin e Bankës së Shqipërisë, i përngjau një konkursi klasik, ku ekipet, të vendosura në formën e një tryeze të rrumbullakët, konkurruan për rreth 90 minuta përpara panelit të jurisë, të përbërë nga drejtues të lartë të Bankës Qendrore. Konkurrentët u përballën me një sërë pyetjesh të kategorive të ndryshme, si pyetje me shtjellim, pyetje rrufe, pyetje me plotësim termash, një zgjidhje ushtrimi, një interpretim grafiku, duke e mbyllur konkurrimin me përgjigjen e një pyetjeje, të përgatitur nga vetë ekipet pjesëmarrëse për njeri tjetrin.



Faza finale u zhvillua në sallën “Black Box” të Akademisë së Lartë të Arteve, ku tri skuadrat finaliste shfaqën njohuritë e tyre përpara një publiku prej afro 200 vetash. Aktiviteti u transmetua edhe në Televizionin Publik Shqiptar.

Në vitin e parë të zhvillimit të tij dhe vetëm për qytetin e Tiranës në konkurs morën pjesë 60 nxënës, ndërkohë që 600 nxënës e mësues ndoqën nga afër këtë aktivitet në të dyja fazat e tij.

“VLERA E VËRTETË E PARASË”, VLORË, DHJETOR 2008

I surprizuar nga rezultati dhe niveli i njohurive, që nxënësit pjesëmarrës paraqitën në konkursin e qytetit të Tiranës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht kryetari i jurisë së konkursit premtoi se ky aktivitet do të zhvillohej edhe në rrethe të tjera të vendit. Rrethi i parë që ai i Vlorës. Në konkurs, i cili u zhvillua në sallën e teatrit “Petro Marko” morën pjesë 17 shkolla dhe 51 nxënës nga qyteti dhe fshatrat e këtij rrethi. Ai u ndoq nga rreth 400 nxënës dhe mësues. Faza finale e këtij aktiviteti u filmua dhe transmetua nga televizioni “KLAN”.



4. BROSHURAT EDUKATIVE.



Përgatitja dhe shpërndarja e tyre për nxënësit e shkollave të mesme në vazhdimësi, shoqërohet edhe me biseda të drejtpërdrejta në mjediset e shkollave. Gjatë viteve 2007-2008 Banka e Shqipërisë ka shpërndarë rreth 21230 broshura edukative me 13 tituj të ndryshëm, në 30 shkolla të mesme të Tiranës dhe në 20 të rrethit të Vlorës.

5. "DITA E BANKËS".



Ky aktivitet mbahet në ditë të veçanta të vitit. Ai u krijon mundësinë studentëve që të ndjekin prezantime dhe të zhvillojnë takime e biseda me specialistë e drejtues të Bankës së Shqipërisë. Temat e trajtuara në to lidhen me çështje të ndryshme të bankingut qendror e më gjerë. Në ditë të tilla, Banka e Shqipërisë organizon minipanaire të botimeve të saj nga raportet e ndryshme periodike, nga librat e konferencave dhe materialet e diskutimit, si edhe nga broshurat e fletëpalosjet e shumta edukative.



6. TËRHEQJA E OPINIONIT.

Rreth 300 mësues dhe nxënës të viteve të treta të shkollave të mesme të përgjithshme të kryeqytetit dhe rreth 200 të shkollave të mesme të

qytetit të Vlorës, u intervistuan në lidhje me aspektet më kryesore të programit edukativ që Banka e Shqipërisë ndërmori gjatë periudhës 2007-2008. Të njëjtët pyetësorë iu shpërndanë edhe 60 punonjësve socialë të kryeqytetit që morën pjesë në një seminar trajnues, organizuar nga Banka e Shqipërisë. Anketa u konceptua me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. Opinioni i të intervistuarve në lidhje me shkallën e njohjes së rolit të Bankës së Shqipërisë në ekonominë e vendit, tregoi se konceptimi dhe zbatimi i programit edukues rezultoi i dobishëm për ta. Për më tepër, nëpërmjet shprehjes së opinionit të tyre nxënësit, mësuesit dhe punonjësit socialë mbështesin idenë e vijimit të këtij projekti mjaft interesant, me vlera të veçanta njohëse e edukative. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve pritet që fazat e ardhshme të programit edukativ të jenë përsëri të drejtuara nga temat e tyre të interesit si ekonomia, bankat dhe financat.

7. SEMINARI PËR PUNONJËSIT SOCIALË TË KRYEQYTETIT.



Ky seminar zhvillohet një javë në vit dhe aktualisht trajton tema që lidhen me bankën qendrore dhe edukimin ekonomiko-financiar. Nisur nga fakti që Banka e Shqipërisë nuk e ka të lehtë të kontaktojë drejtpërdrejt me publikun e përgjithshëm, ndihma e punonjësve socialë për përçimin e informacionit është vlerësuar si mjaft e dobishme. Dhe kjo për vetë natyrën e profesionit të tyre, të cilët kanë kontakte të shpeshta me shtresa të ndryshme të popullsisë.

Për vitin 2008, 60 punonjës socialë që ndoqën seminarin u pajisën me certifikata pjesëmarrjeje në mbyllje të aktivitetit. Duke filluar që prej qershorit të vitit 2008, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në seminar u regjistruan në listën elektronike të përfituesve të botimeve të Bankës së Shqipërisë.

LEKSIONET E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI, NË UNIVERSITETE JASHTË VENDIT.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, i kushton vëmendje edhe mbajtjes së leksioneve në universitete, ndër më të njohurat në botë.

Ai shfrytëzon takimet me homologë të tij për të zhvilluar leksione dhe biseda të hapura me studentë.

Gjatë vitit 2007, z. Fullani dha një leksion në Universitetin Bocconi në Milano dhe një tjetër në London School of Economics (Shkolla për shkenca politike dhe ekonomike në Londër).

Në këto takime ai ka diskutuar rreth politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, zhvillimeve ekonomike që kanë karakterizuar vendin tonë gjatë viteve të fundit, konvertimit ekonomik dhe institucional të Evropës Juglindore drejt Bashkimit Evropian, çështjeve të zhvillimit të sistemit financiar të rajonit, karakteristikave të përbashkëta si dhe sfidave me të cilat ai përballlet, politikave për zbutjen e dobësive financiare etj..

SEMINARE PËR GAZETARËT.

Në këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë, mediat përfaqësojnë një nga përçuesit kryesorë të informacionit në lidhje me tregjet financiare dhe gjendjen ekonomike, në publik. Për këtë arsye dhe për të plotësuar boshllëkun informativ e edukativ që ka ekzistuar në shoqërinë shqiptare mbi çështje të natyrës ekonomiko-financiare, duke filluar nga viti 2003, Banka ka konsoliduar traditën e zhvillimit të seminareve trajnuese për gazetarët ekonomikë. Me anë të këtyre seminareve, synohet të rritet shkalla e njohjes së institucionit të Bankës së Shqipërisë nga përfaqësuesit e mediave, në mënyrë që informimi i publikut mbi vendimet e bankës qendrore dhe interpretimi i tyre të jetë sa më i drejtë, i saktë dhe të mos lërë vend për keqkuptime.



“ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË”.

“Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë” është një konkurs që Banka e Shqipërisë organizon për studentët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Studentët që ndjekin vitin e fundit të universitetit në lëndën e ekonomisë apo financës, mund të përdorin diplomat e tyre edhe për të marrë pjesë në këtë konkurs.

Deri në fund të vitit 2008 aktiviteti është zhvilluar dy herë, gjatë së cilave janë grumbulluar rreth 30 diploma dhe janë shpërndarë 6 çmime. Kjo nismë e Bankës Qendrore synon të nxisë studentët të ndërmarrin studime të thelluara në fushën e bankingut qendror dhe të ekonomisë, në përgjithësi. Gjithashtu ajo është një përpjekje për të ndërgjegjësuar më tepër opinionin publik mbi rëndësinë e thithjes së elementeve premtuese në Shqipëri, dhe punësimit të atyre që aspirojnë zhvillim dhe karrierë.



TAKIME ME PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË FUSHËS SË EDUKIMIT.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, fton në hollin e Bankës së Shqipërisë përfaqësues të organizatave joqeveritare, të institucioneve të specializuara në fushën e edukimit dhe çështjeve sociale, si edhe të institucioneve shtetërore.

Këto takime kanë një qëllim kryesor: zhvillimin e bisedave të hapura mes Guvernatorit dhe të pranishmëve. Ato kanë për objekt bashkëpunimin lidhur me çështjet e edukimit ekonomik dhe financiar që Banka e Shqipërisë synon të ketë me institucionet, dhe organizatat që ata përfaqësojnë.

Nëpërmjet këtyre individëve dhe për arsye të profesionit të tyre, Banka e Shqipërisë synon të arrijë tek publiku i përgjithshëm ose më mirë, tek të gjithë ata, që për arsye të ndryshme, kanë kontakt me përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve të lartpërmendura.



VENDOSJA E STENDAVE ME BOTIME EDUKATIVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË ZYRAT QENDRORE TË BANKAVE TREGTARE TË KRYEQYTETIT.



Banka e Shqipërisë mundohet t'i gjendet sa më afër publikut në jetën e tij të përditshme!

Mjediset e bankave tregtare janë vende, të cilat frekuentohen pa ndërprerje nga shumë qytetarë të Tiranës. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka vendosur në çdo zyrë qendrore të bankave tregtare të kryeqytetit stenda me botimet e saj edukative. Deri në fund të vitit 2008, në këto stenda janë shpërndarë 16 000 botime edukative, ndërsa në hollin e Bankës së Shqipërisë janë tërhequr nga publiku 13 300 të tilla.

SLOGANET TONA MBI EDUKIMIN GJATË VITEVE 2007-2008:

- ROLI I BANKËS QENDRORE NË EKONOMI.
- KA GJITHMONË DIÇKA MË SHUMË PËR TË MËSUAR PËR PARANË!
- VLERA E VËRTETË E PARASË.
- EDUKIMI KUSHTON POR NUK KA ÇMIM!



DISA SHIFRA NGA AKTIVITETET EDUKUESE TË BANKËS SË SHQIPËRISË:

- 21230 BOTIME EDUKATIVE TË SHPËRNDARA.
- 20 TAKIME ME GRUPE TË NDRYSHME SHOQËRORE.
- 76 ORË LEKSIONE TË MBAJTURA PREJ 20 SPECIALISTËVE E DREJTUESVE.
- 510 PYETËSORË TË SHPËRNDARË.
- 14 TAKIME TË GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË ME GRUPE INTERESI TË NDRYSHME.
- 133 KOMENTE TË SHTYPIT VETËM PËR ÇËSHTJET E EDUKIMIT.
- 50 TRANSMETIME TELEVIZIVE PËR AKTIVITETET E EDUKIMIT.
- 170 DIPLOMA TË DORËZUARA

NË VEND TË MBYLLJES..

Siç e shikoni, nuk ka vend për shumë fjalë pas gjithë kësaj pune. Dua vetëm të shtoj se ajo që duhet të besoni është që njohuritë financiare, janë si një çelës për të jetuar me dinjitet në jetën e përditshme të të gjithëve ne! Ato gjithashtu, janë “një dhuratë” që secili duhet t’i bëjë vetes për të qenë denjesisht, qytetar i botës.

Guvernatori



Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:
www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonti në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej" Nr.1, Tiranë, Shqipëri.

Tel.: +355-(0)4-2222152;

Faks: +355-(0)4-2223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:
public@bankofalbania.org

Tirazhi: 5000 kopje